

BULETIN



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT

Shtator 2004

Buletin mujor Nr.9

Ky botim përgatitet në kuadër të transparencës me publikun dhe mundësohet me mbështetjen financiare të CORDAID “CATHOLIC ORGANISATION FOR RELIEF AND DEVELOPMENT”

PASQYRA E PËRMBAJTJES

1. VEPRIMTARI VËZHGUESE TË KSHH-SË

- 1.1 Monitorim nga përfaqësues të KSHH-ë të seancës gjyqësore të Ferhat Cekës në Selanik
- 1.2 Raund misionesh vëzhgimi në komisariate, vënde paraburgimi dhe burgje

2. VEPRIMTARI SENSIBILIZUESE DHE EDUKUESE

- 2.1 Takime me autoritetet shtetërore dhe aktorë të tjerë të shoqërisë civile
- 2.2 Takime me familjarë të emigrantëve shqiptarë në Greqi

3. PUBLIKIMET E KSHH-SË GJATË MUAJIT QERSHOR 2004

- 3.1 Fletëpalosja sensibilizuese dhe informuese “A mund të rishikohen vendimet gjyqësore të formës së prerë? Çfarë rruge ndiqet dhe ku duhet të drejtohesh?”

4. TRYEZA DHE KONFERENCA

- 4.1 Konferenca për shtyp “Reforma zgjedhore”

- 4.2 Takim vlerësues për veprimtarinë e rrjetit të korrespondentëve në shtatë rrethe të vendit
- 4.3 Trajnimi i vëzhguesve të KSHH-së për raundin e vëzhgimeve në vëndet e paraburgimi dhe në burgje

5. REAGIME PUBLIKE TË KSHH-SË NDAJ SHKELJEVE TË TË DREJTAVE TË NJERIUT (DEKLARATA PËR SHTYP)

6. SHTETASIT I DREJTOHEN KSHH-së (Ankesat dhe raste verifikimi)

7. KSHH DHE MEDIA

ANEKS Nr. 1 - DEKLARATA

1. Fajtorët para përgjegjesisë
2. Njoftim për shtyp “Mbi konferencën e përbashkët për shtyp të Grupit Grek dhe Komitetit Shqiptar të Helsinkit, në Selanik”
3. Njoftim për shtyp - Lidhur me ecurinë e reformës zgjedhore në Shqipëri
4. Më tepër tolerancë ndaj medias, më tepër kujdes ndaj heqjes së imunitetit

ANEKS Nr. 2 – KSHH NË MEDIA (informacion statistikor)

**Rr: “Gjin Bue Shpata”, Pall. 5/1; Ap.4, Tiranë, Kutia postare Nr. 1752, Tel: 04 233671; 04229002
Fax: 04 233671; CEL: 068 20 23699; E-mail: office@ahc.org.al; web-site: www.ahc.org.al**

1. VEPRIMTARI VËZHGUESE TË KSHH-SË

1.1 Monitorim nga përfaqësues të KSHH-së të seancës gjyqësore të Ferhat Cekës në Selanik

Në 16 shtator 2004 përfaqësues të KSHH-së dhe të Grupit Grek të Helsinkit monitoruan procesin gjyqësor të emigrantit shqiptar z. Ferhat Ceka që u zhvillua kundër dy ushtarëve greke. Ky është gjyqi i parë që zhvillohet kundër dhunës së ushtruar ndaj një emigranti shqiptar.

Një ditë përpara së të zhvillohej procesi gjyqësor, përfaqësues të Grupit të Helsinkit Grek dhe të KSHH-së dhanë një Konferencë për shtyp. Në të u paraqitën disa shqetësime të të dy organizatave, si për veprimet diskriminuese ndaj z. F. Cekës për të siguruar një vizë greke për të dëshmuar në gjyq, mungesën e një mjeti të përshtatshëm në Aeroportin e Athinës për transportimin e tij, për fenomenin e ksenofobisë dhe albanofobisë nga një pjesë e qytetarëve grekë ndaj emigrantëve shqiptarë, keqtrajtimin e emigrantëve në kufirin grek, shkeljen e të drejtave të emigrantëve shqiptarë në proceset gjyqësore, si të drejtën për avokat, të drejtën për përkthyes, dhënien e dënimeve më të ashpra për shqiptarët sesa për grekët, etj.,

Konferenca gjeti një pasqyrim të madh në median greke të shkruar dhe elektronike, gjithashtu nuk u la pa përmëndur as nga media shqiptare.

1.2 Raund misionesh vëzhgimi në komisariate, vende paraburgimi dhe burgje

Në zbatim të misionit sensibilizues dhe edukues në drejtim të respektimit të lirive dhe të drejtave të njeriut, të të drejtave të personave të arrestuar dhe të dënuar, Komiteti Shqiptar i Helsinkit ka filluar një raund misionesh vëzhgimi në komisariate, vendet e paraburgimit dhe burgje. Ky raund do të kryhet deri në muajin dhjetor. Qëllimi i vëzhgimit është për të parë nga afër respektimin e të drejtave të të dënuarve dhe të paraburgosurve, trajtimin e tyre nga administrata e institucioneve penitenciare, identifikimin e shkeljeve dhe mangësive institucionale si dhe marrjen e masave konkrete.

Procesi i monitorimit mbulon burgjet si dhe 16 vende paraburgimi (komisariate) nga 25 të tilla ekzistuese në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Në këtë raund misionesh vëzhgimi do të marrin pjesë 40 vëzhgues specialistë dhe studentë të profesioneve të ndryshme si juristë, mjekë, psikologë dhe sociologë.

Në fund të vëzhgimeve, KSHH-ja do të përpilojë një raport përfundimtar mbi rezultatet e vëzhgimeve në vendet e paraburgimit dhe burgjet, raport i cili do të paraqesë rekomandimet përkatëse për strukturat përgjegjëse shtetërore për përmirësimin e situatës dhe respektim më të mirë të të drejtave të të paraburgosurve dhe të dënuarve. Në përfundim të vëzhgimeve, KSHH-ja do të bëjë prezente përfundimet e vëzhgimeve.

2. VEPRIMTARI SENSIBILIZUESE DHE EDUKUESE

2.1 Takime me autoritetet shtetërore dhe aktorë të tjerë të shoqërisë civile

Gjatë muajit shtator 2004, përfaqësues të KSHH-së kanë bërë takime dhe kanë mbajtur kontakte të rregullta me përfaqësues të ndryshëm të autoriteteve shtetërore.

Gjatë kësaj periudhe KSHH i është drejtuar 12 institucioneve shtetërore për trajtimin e problemeve të ndryshme të hasura gjatë veprimtarisë së KSHH-së. Institucionet e ndryshme kanë kthyer përgjigje për çështjet e ngritura nga KSHH-ja. Lidhje të tilla KSHH ka patur më tepër me

Ministrinë e Drejtësisë, Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve, Ministrinë e Rendit Publik, Organet e Prokurorisë, administratën e vëndeve të paraburgimit dhe burgjeve, etj., Bashkëpunim të kënaqshëm në forma të ndryshme KSHH ka patur jo vetëm me institucione vendore dhe me organizata vendase por dhe me të huaja, organizata partnere ose organizata si-motra, si psh Komitetin Norvegjez të Helsinkit, Komitetin Suedez të Helsinkit, Grupin Grek të Helsinkit, Amnesty International, IHF, etj.,

2.2 Takime me familjarë të emigrantëve shqiptarë, viktime të dhunës policore greke

Gjatë muajit shtator Komiteti Shqiptar i Helsinkit ka kontaktuar me familjarë të emigrantëve shqiptarë në Greqi të cilët kanë pësuar ngjarje të rënda dhe disa prej tyre kanë patur dhe fate tragjike. Në këtë kuadër përfaqësues të KSHH-së kanë realizuar takime me familjarët e Luan Bërdëllimës, emigrant shqiptar i cili pretendohet të jetë vlarë nga policia greke, Gramoz Palushi. Pas ngjarjes së rëndë të ndodhur në Greqi përfaqësues të Komitetit Shqiptar të Helsinkit realizuan një takim me familjarët e tij.

Gjithashtu në zyrat e KSHH-së kanë ardhur 29 familjarët e personave nga Maqellara e Dibrës të zhdukur në vitin 1996, të cilët pretendohet që të jenë në Greqi.

KSHH i ka këshilluar dhe udhëzuar këta persona për të përgatitur dokumentacionin përkatës i cili është dërguar më pas pranë Grupit të Helsinkit Grek, i cili po heton në vend shkaqet e këtyre ngjarjeve tragjike.

2.3 Takime me përfaqësues të emigrantëve në Greqi dhe me përfaqësues të Konsullatës Shqiptare në Selanik

Në kuadër të vizitës së përfaqësuesve të KSHH-së në Selanik, Greqi, u morën takime me përfaqësues të Konsullatës shqiptare në Selanik të Greqisë dhe përfaqësues të shoqatave të emigrantëve. Qëllimi i takimeve ishte diskutimi i problemeve që shqetësonin emigrantët shqiptarë dhe roli i përfaqësive shqiptare në mbrojtje të të drejtave të emigrantëve. Përfaqësuesit e këtyre organizatave ngritën shqetësime lidhur me procedurat e gjata dhe të shtrenjta të rinovimit të lejeve të qëndrimit në Greqi, të respektimit të të drejtave të tyre në punë, të mbrojtjes në punë, të trajtimit nga policia greke, etj.,

Në takim mori pjesë z. Ilirjan Zhupa, konsulli i përgjithshëm i Shqipërisë së Selanik, përfaqësues të shoqatave të emigrantëve shqiptarë në Selanik.

3. PUBLIKIMET E KSHH-SË GJATË MUAJIT SHTATOR 2004

3.1 Fletëpalosja sensibilizuese dhe informuese “A mund të rishikohen vendimet gjyqësore të formës së prerë? Çfarë rruge ndiqet dhe ku duhet të drejtohesh?”

KSHH së fundmi ka nxjerrë fletëpalosjen “A mund të rishikohen vendimet gjyqësore të formës së prerë? Çfarë rruge ndiqet dhe ku duhet të drejtohesh?” Në adresë të KSHH-së kanë ardhur ankesa nga të dënuar dhe familjarë të tyre ku objekt ka qënë dhe çështja për rishikimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë. Për t’u ardhur në ndihmë shtetasve, KSHH ka përgatitur fletëpalosjen “A mund të rishikohen vendimet gjyqësore të formës së prerë? Çfarë rruge ndiqet dhe ku duhet të drejtohesh?” Në këtë fletëpalosje janë paraqitur disa pyetje për situata të ndryshme si dhe janë dhënë përgjigjet sqaruese në përputhje me ligjin me një gjuhë të thjeshtë. Qëllimi i botimit të kësaj fletëpalosje është ardhja në ndihmë të dënuarve dhe këshillimi i tyre për rrugët ligjore që duhet të ndjekin për paraqitjen e një kërkesë në Gjykatën e Lartë për rishikim të

vendimit gjyqësor të formës së prerë në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Kodin e Procedurës Penale.

Gjithashtu ata mund të marrin këshillim për rastet kur mund të kërkohet rishikimi i një vendimi gjyqësor të formës së prerë, se kush janë subjektet që legjitimohen të bëjnë një kërkesë të tillë, ku duhet paraqitur kjo kërkesë dhe çfarë elementësh duhet të përmbajë ajo. Kjo fletëpalosje është duke u shpërndarë në të gjitha vendet e paraburgimit dhe institucionet e vuajtjes së dënimit në Republikën e Shqipërisë si edhe të gjithë të interesuarve rreth kësaj çështje¹.

4. TRYEZA DHE KONFERENCA

KSHH-ja ka organizuar takime me ekspertë dhe tryeza të rumbullakta si dhe konferenca për shtyp për tematika të caktuara me qëllim përmirësimin e ligjit dhe përmirësimin e praktikës së zbatimit të ligjit dhe respektimit të të drejtave të shtetasve.

4.1 Konferencë për shtyp “Reforma zgjedhore”

Në datën 20 shtator 2004 KSHH zhvilloi një konferencë për shtyp për disa çështje që janë shqetësues për reformën zgjedhore. Dy ishin problemet e diskutuara në këtë konferencë: përgatitja e saktë dhe e plotë e Listës së Zgjedhësve, garantimi i ushtrimit të të drejtës së votës, si një e drejtë themelore dhe krijimi i komisioneve zgjedhore të pavarura, të paanshme dhe jo partiake që zbatojnë vetëm ligjin.

KSHH nënvizoi se për zgjidhjen e këtyre problemeve nuk mjafton vetëm vullneti politik për konsensus, por kërkohet ndërtimi i një Kodi Zgjedhor që të mbyllë shtigjet e çdo manipulimi dhe të ngjallë besimin jo vetëm të subjekteve zgjedhore, por edhe të çdo zgjedhësi.

Që të ekzistojnë komisione të pavarura, të paanshme dhe jo partiake dhe që të zbatojnë vetëm ligjin sipas rekomandimeve të OSBE/ODIHR-it dhe Komisionit të Venecias duhet që jo më vonë se 180 ditë para zgjedhjeve, Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve duhet të ketë trajnuar të gjithë anëtarët e komisioneve të zgjedhjeve (KZZ, KZQV, KQV), të ketë bërë testimin e tyre dhe në përfundim t'i ketë pajisur ata me certifikatën përkatëse që do të vërtetojë aftësinë e tyre për të kryer këtë detyrë.

Nëpërmjet kësaj konference, KSHH-ja u bëri thirrje të gjitha forcave politike dhe qeverisë që të vlerësojnë seriozisht situatën e krijuar. Në këtë konferencë përveç medias merrnin pjesë dhe përfaqësues të organizatave joqeveritare vendase.

4.2 Takim vlerësues për veprimtarinë e rrjetit të korrespondentëve në shtatë rrethe të vendit

Më 25 shtator 2004, Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KSHH) organizoi një takim vlerësues mbi veprimtarinë dhe kontributin e dhënë nga rrjeti i korrespondentëve të KSHH-së që për periudhën kohore Janar 2002 - Shtator 2004 kanë vëzhguar nga afër situatën e të drejtave të njeriut në shtatë rrethe të vendit si Kukës, Gjirokastrë, Fier, Vlorë, Korçë, Elbasan, Shkodër².

¹ Publikimi i kësaj fletëpalosje është bërë në kuadër të projektit “Reforma në burgje dhe roli i shoqërisë civile në Shqipëri” i mbështetur financiarisht nga Komiteti Suedez i Helsinkit.

² Ky rrjet ka funksionuar falë mbështetjes financiare akorduar KSHH-së nga fondacioni SOROS, Tiranë.

Në këtë tryezë përveç stafit të KSHH-së dhe korrespondentëve të tij, morën pjesë anëtarë të KSHH-së, si edhe anëtarë të bordit të këtij Komiteti të cilët kanë parë dhe vlerësuar nga afër punën e korrespondentëve gjatë misioneve të përbashkëta mbështetëse.

Në këtë takim vlerësues u bë një prezantim i gjithë veprimtarisë së larmishme të korrespondentëve të KSHH-së nëpër rrethe. Të pranishmit u njohën midis të tjerash me fushat e të drejtave të njeriut që janë vëzhguar në organet e sistemit gjyqësor, komisariatet e policisë dhe vendet e paraburgimit, organet e qeverisjes vendore, organet përgjegjëse për administrimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore etj. Gjithashtu, u sollën shifra konkrete të cilët evidentonin numrin gjithnjë në rritje të rasteve të trajtuara dhe verifikuara nga korrespondentët e KSHH-së në rrethe, gjë që flet qartë për prezencën gjithnjë në rritje të tyre tek qytetarët e thjeshtë në rrethe.

Referuesit në këtë takim nënvizuan se krahas veprimtarisë vëzhguese, korrespondentët e KSHH-së nëpërmjet formave të ndryshme sensibilizuese kanë dhënë kontributin e tyre në rritjen e ndërgjegjesimit të shtetasve të thjeshtë për të denoncuar rastet e shkeljeve të të drejtave të tyre nga administrata shtetërore.

Në përfundim të takimit u zhvilluan diskutime nga të pranishmit në lidhje me të ardhmen e këtij rrjeti dhe fushat në të cilët do të veprojë ky rrjet. Pjesëmarrësit në këtë takim theksuan se ekzistenca e rrjetit të korrespondentëve e KSHH-së edhe në të ardhmen është e nevojshme. Ky rrjet jo vetëm do të vazhdojë të forcojë veprimtarinë vëzhguese dhe reaguese të KSHH-së por gjithashtu do të shërbejë si faktor i rëndësishëm presioni tek organet shtetërore vendore për një respektim më të mirë të të drejtave të shtetasve nga ana e tyre. Rrjeti do të vazhdojë të kontribuojë në rritjen e kulturës ligjore në rrethe si edhe në nxitjen e guximit qytetar për të denoncuar dhe vënë para përgjegjësisë ligjore shkelësit e të drejtave të shtetasve.

4.3 Trajnimi i vëzhguesve të KSHH-së për raundin e vëzhgimeve në vendet e paraburgimi dhe në burgje

Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KSHH) ashtu siç është përmendur dhe më sipër ka planifikuar që së shpejti të monitorojë kushtet në vendet e paraburgimit dhe burgje si dhe respektimin e të drejtave të të arrestuarve dhe të dënuarve nga ana e administratës në këto institucione.

Për kryerjen e këtij vëzhgimi janë përzgjedhur si vëzhgues 10 specialistë me përvojë, si edhe 18 të sapodiplomuar dhe studentë në fusha të tilla si drejtësi, mjekësi, sociologji, psikologji, dhe punë sociale.

Më datë **24 Shtator 2004** me të gjithë vëzhguesit së bashku me stafin dhe korrespondentët e KSHH-së në shtatë rrethet e vendit u organizua një trajnim një ditor³.

Gjatë këtij trajnimi vëzhguesit u njohën me misionin, dhe veprimtarinë e KSHH-së si edhe me objektivat dhe veprimtarinë konkrete të projektit “Reforma në burgje dhe roli i shoqërisë civile në Shqipëri”. Në këtë trajnim u trajtuan çështje që lidhen me vëzhgimin nëpër institucione penitenciare, kuadrin ligjor dhe aspekte të veçanta të ligjit; si respektimin e afateve procedurale në paraburgim, respektimin e disa të drejtave të të paraburgosurve dhe të të dënuarve të garantuara në ligj të cilat përbëjnë boshtin e këtij raundi vëzhgimesh. Pati një seancë pyetjesh, diskutimesh dhe sqarimesh mbi çështje të ndryshme që u trajtuan. Të gjithë të pranishmit e vlerësuan këtë trajnim si të domosdoshëm dhe të vlefshëm.

5. REAGIME PUBLIKE TË KSHH-SË NDAJ SHKELJEVE TË TË DREJTAVE TË NJERIUT (DEKLARATA PËR SHTYP)

³ Ky aktivitet u zhvillua në kuadër të projektit “Reforma në burgje dhe roli i shoqërisë civile në Shqipëri” mundësuar financiarisht nga Komiteti Suedez i Helsinkit


Ndaj shkeljeve të të drejtave të njeriut, krahas letrave dhe rekomandimeve drejtuar autoriteteve shtetërore, gjatë muajit shtator, KSHH-ja ka reaguar publikisht me **4 deklarata**. Objektet e tyre kanë qënë liria e shtypit, reforma zgjedhore, keqtrajtimet e emigrantëve shqiptarë nga policia kufitare greke. Nëpërmjet deklaratave KSHH i bën thirrje autoriteteve shtetërore përkatëse dhe opinionit publik që t'u kushtojnë vëmendje këtyre problemeve. Sinjalizimet për këto probleme kanë ardhur nga ankesat të shumta të mbërritura në adresë të KSHH-së, nga rastet e verifikuara nga korrespondentët e KSHH-së në 7 rrethet e vëndit si dhe problematika që trajtohet nga media.⁴

6. SHTETASIT I DREJTOHEN KSHH-së

KSHH gjatë muajit shtator 2004 ka marrë gjithsej 38 ankesa, 23 prej tyre, kanë ardhur nga personat të cilët gjenden në vendet e paraburgimit dhe burgjet.

Objekt i ankesave është kryesisht për vendime të padrejta gjyqësore dhe kërkesa për rishikimin e tyre. Sipas ankuesve kjo ndodh për shumë faktorë por kryesori është korrupsioni i sistemit të drejtësisë, i organeve dhe i administratës së gjyqësorit, etj.,

Më konkretisht mund ti shikoni si më poshtë mund të ndiqni fushat në grafikun e paraqitur.



Për zgjidhjen e problemeve të ngritura nevojitet një bashkëpunim i mirë i KSHH-së me shumë autoritete qeveritare dhe me organizata të ndryshme jofitimprurëse.

Raste verifikimi

KSHH përveç marrjes së ankesave, ajo verifikon dhe trajton rastet e sinjalizuara nga korrespondentët të KSHH-së, media, qytetarë, etj.

Gjatë muajit shtator 2004, pas ngjarjes së rëndë të ndodhur në Greqi, atë të vrasjes së emigrantit shqiptar Gramoz Palushit, përfaqësues të Komitetit Shqiptar të Helsinkit u takuan me familjarët e tij. Ky takim u realizua në kuadër të nismës së KSHH-së, që në bashkëpunim me Grupin e

⁴ Më konkretisht shih Aneks Nr.1 në këtë buletin

Helsinki Grek për të denoncuar rastet e keqtrajtimit të emigrantëve shqiptarë, dhe të kërkojnë rivendosjen e të drejtave të tyre të shkelura.

Gjithashtu një sërë rastesh verifikimesh janë kryer dhe në burgje dhe vëndet e paraburgimit nga stafi i KSHH-së dhe nga korrespondentët e tij. Në shtator u vëzhgua në vend (në komisariatit e Elbasanit) shkaku i futjes në grevë të një prej të paraburgosurve dhe rezultoi se ishte zvarritja e herëpashershme e procesit gjyqësor kundër tij.

7. KSHH DHE MEDIA

Në tërësi gjatë vitit 2004, është vënë re një rritje e publikimit të deklaratave të KSHH-së, të aktiviteteve të ndryshme të tij si në median e shkruar dhe atë elektronike. Gjatë muajit shtator 2004, anëtarë të KSHH-së kanë trajtuar një sërë problemesh me anë të shkrimeve si dhe opinionëve në media. Në intervistat dhe shkrimet e mësipërme janë trajtuar kryesisht probleme të reformës zgjedhore, të keqtrajtimit të emigrantëve shqiptarë, etj.,⁵

ANEKS NR. 1 – DEKLARATA

1. Fajtorët para përgjegjesisë

Tiranë, më 6 shtator 2004

Komiteti Shqiptar i Helsinkit dënon sulmin e egër vdekjeprurës në ishullin Zakinto të Greqisë ndaj emigrantit shqiptar Halil Palushi, vetëm sepse ai demonstroi gëzimin e tij të natyrshëm dhe të ligjshëm për fitoren e ekipit shqiptar në ndeshjen e futbollit Shqipëri-Greqi që u zhvillua në Tiranë në 4 shtator 2004. Sipas njoftimeve të agjensive të huaja dhe të medias shqiptare, po për këtë shkak, në disa qytete greke u keqtrajtoan edhe emigrantët të tjerë shqiptarë, madje pati edhe shtrime në spitale. KSHH shpreh ngushëllimet e tij të thella për familjen dhe të afërmit e viktimës, ndërsa të lënduarve u uron shërim të shpejtë.

KSHH, aktet e mësipërme të dhunës i konsideron si fenomene tepër negative që cënojnë atmosferën e shëndoshë midis popujve tanë dhe që mbartin elemente të një patriotizmi të sëmurë, të ekstremizmit, ksenofobisë dhe rrugaçërisë. Akte të tilla nuk kanë asgjë të përbashkët me frymën sportive që shërben si urë lidhjeje midis popujve ku konkurrenca e ndershme dhe profesionale kërkon mbështetje, respekt dhe inkurajim.

KSHH përshëndet me këtë rast deklaratën e zëdhënësit të Qeverisë Greke që dënon hapur dhe në mënyrë kategorike incidentet e vërtetuara dhe që premtun marrjen e masave përkatëse për vënien e fajtorëve para përgjegjesisë ligjore.

KSHH do të dëshironte që raste të tilla të mos përsëriteshin në të ardhmen, ndërsa ato që ndodhën, të mos shoqëroheshin me pasoja të tjera të dëmshme.

KSHH e sheh të nevojshme që të rikujtojë mesazhin e freskët të lojrave olimpike për paqe, barazi dhe vllazërim për shpalosjen e kulturës, arritjeve dhe të traditave të çdo vendi për miqësi dhe mirëkuptim midis popujve.

2. Njoftim për shtyp - Mbi konferencën e përbashkët për shtyp të Grupit Grek dhe Komitetit Shqiptar të Helsinkit, në Selanik

Tiranë, më 15 Shtator 2004

⁵ Për një informacion statistikor mund të gjeni më shumë në aneksin Nr.2 të këtij buletini

Sot më 15 shtator 2004, në orën 11.30 në Qendrën Balkanike “Media” në Selanik, është mbajtur një konferencë e përbashkët për shtyp e Grupit Grek dhe Komitetit Shqiptar të Helsinkit. Në Konferencë merrnin pjesë Drejtorja Ekzekutive e Komitetit Shqiptar të Helsinkit, Znj. Vasilika Hysi, Z. Panayote Dimitras, përfaqësues i Grupit Grek të Helsinkit dhe Ferhat Çeka, një nga viktimat e keqtrajtimit nga policia kufitare Greke. Përfaqësuesit e Grupit Grek dhe Komitetit Shqiptar të Helsinkit do të ndjekin procesin gjyqësor.

Konferenca për shtyp është mbajtur një ditë para se të zhvillohet gjyqi penal në Gjykatën Penale Ushtarake të Selanikut ndaj autoriteteve ushtarake Greke. Ky është gjyqi i parë i këtij lloji, i cili zhvillohet kundër dhunës së përdorur ndaj Z. Çeka në 8 mars të vitit 2002.

Në deklaratën për shtyp, Z. Dimitras ka shprehur revoltën e tij lidhur me disa fakte të cilat janë interpretuar si veprime diskriminuese ndaj Z. Çeka si, *vështirësia e Z. Çeka për siguruar vizën greke për të dëshmuar në gjyq.*

Si pasojë e një aksidenti të mëparshëm që ka patur, Z. Çeka është kthyer në invalid duke patur vështirësi në ecje. *Megjithëkëtë, atij nuk i është siguruar një mjet lehtësues transporti në aeroportin e Athinës, ndërkohë që në të njëjtën kohë për një qytetar grek ky shërbim është realizuar.*

Më pas fjalën e ka marrë Znj. Vasilika Hysi, Drejtore Ekzekutive e Komitetit Shqiptar të Helsinkit. Në fjalën e saj, ajo pasi ka *falenderuar median e pranishme shprehu angazhimin e Komitetit Shqiptar të Helsinkit që në bashkëpunim me Grupin Grek të Helsinkit të denoncojnë rastet e keqtrajtimit të emigrantëve shqiptarë nga punonjësit dhe policia greke.*

Në fjalën e saj, Znj. Hysi shprehu *shqetësimin për ksenofobinë dhe albanofobinë e një pjese të qytetarëve Grekë ndaj emigrantëve shqiptarë. “Komiteti Shqiptar i Helsinkit nuk mbështet emigrantët shqiptarë që kryejnë krime, madje në këtë aspekt, ata duhen vendosur para drejtësisë, por gjithmonë kjo duhet bërë duke respektuar të drejtat që njihen dhe sigurohen nga dokumentat ndërkombëtarë dhe legjislacioni Grek. Rastet e keqtrajtimit të emigrantëve shqiptarë vazhdojnë”,* tha Znj. Hysi. *Në këtë kuadër Ajo përmendi rastet e fundit tragjike të ndodhura në Greqi siç është rasti i Luan Bërdëllimës (vdekur nga keqtrajtimi që i ka bërë policia Greke) si edhe rasti i Gramoz Palushit (vrrarë pak ditë më parë në ishullin Zakinto të Greqisë).*

Znj. Hysi shprehu shqetësimin e saj për rastet e keqtrajtimit të emigrantëve shqiptarë në kufi, si edhe rastet e tjera flagrante të shkeljes së të drejtave të tyre në proceset gjyqësore, si dhënia e dënimeve më të ashpra për shqiptarët sesa për Grekët, për të njejtat vepra penale. Gjithashtu Znj. Hysi shprehu edhe rastet e tjera të shkeljes së të drejtave të njeriut siç janë dënimi i shqiptarëve në Greqi pa avokat, dhënia e një përkthyesi i cili nuk di gjuhën shqipe, etj.

Znj. Hysi u shpreh se Shqipëria dhe Greqia kanë shumë gjëra që i bashkojnë. Emigrantët shqiptarë në Greqi dhe minoriteti Grek në Shqipëri duhet të shërbejnë si ura lidhjeje dhe jo si ura ndarjeje ndërmjet dy popujve. Ajo u shpreh se gjyqi që do të zhvillohet ditën e nesërme i cili është gjyqi i parë deri më sot ndaj shtetit Grek, do të shërbejë për të minimizuar rastet e keqtrajtimit të emigrantëve shqiptarë në Greqi.

Më pas fjalën e ka marrë Z. Ferhat Çeka i cili ka shpjeguar ngjarjen e ndodhur. Media është interesuar sidomos lidhur me faktin se çfarë do të kërkojë Z. Çeka në senacën e ditës së nesërme. Z. Çeka ka bërë të ditur se ai do të kërkojë ndëshkimin e fajtorëve si dhe dëmshpërblimin material, moral dhe psikologjik.

3. Njoftim për shtyp - Lidhur me ecurinë e reformës zgjedhore në Shqipëri

Tiranë, më 20 shtator 2004

Komiteti Shqiptar i Helsinkit ka ndjekur dhe vazhdon të ndjekë me vëmendje të veçantë përgatitjet për zgjedhjet e ardhshme parlamentare dhe kryesisht ato që kanë të bëjnë me përmirësimet në Kodin Zgjedhor.

Komiteti Shqiptar i Helsinkit, si një organizatë jo-qeveritare që ka monitoruar thuajse të gjitha zgjedhjet e zhvilluara në vendin tonë shpreh keqardhjen dhe shqetësimin e tij për vonesën e theksuar dhe të pajustificueshme lidhur me ndryshimet që duhet t'i bëhen Kodit Zgjedhor në bazë të rekomandimeve të OSBE/ODIHR-it dhe Komisionit të Venecias.

Deri më sot, në këtë drejtim nuk është arritur ndonjë rezultat konkret, kur dihet se sipas rekomandimeve të OSBE/ODIHR-it dhe Komisionit të Venecias është e nevojshme të rishikohen apo të riformulohen rreth 84 nene të Kodit Zgjedhor ose afërsisht 46% të krejt dispozitave të këtij Kodi.

Për Komitetin Shqiptar të Helsinkit dy janë çështjet kryesore që e shqetësojnë atë:

Së pari, përgatitja e saktë dhe e plotë e Listës së Zgjedhësve, për të garantuar ushtrimin e të drejtës së votës, si një e drejtë themelore. Për këtë nuk mjafton vetëm vullneti politik për konsensus, por kërkohet ndërtimi i një kodi zgjedhor që të mbyllë shtigjet e çdo manipulimi dhe të ngjallë besimin jo vetëm të subjekteve zgjedhore, por edhe të çdo zgjedhësi.

Sipas nenit 55 të Kodit Zgjedhor në fuqi, zyrat e gjendjes civile, jo më vonë se 7 muaj para mbarimit të mandatit të Kuvendit (d.m.th. qysh në muajin Nëntor 2004) duhet të fillojnë punën për hartimin e listave paraprake. Por që të fillosh këtë, duhet të plotësohen dhe saktësohen të gjitha defektet dhe mungesat e vërtetuara në zgjedhjet e 12 Tetorit 2003.

Së dyti, krijimi i komisioneve zgjedhore të pavarura, të paanshme dhe jo partiake që të zbatojnë vetëm ligjin.

Sipas rekomandimeve të OSBE/ODIHR-it dhe Komisionit të Venecias, jo më vonë se 180 ditë para zgjedhjeve (d.m.th. deri në muajin Dhjetor 2004) Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve duhet të ketë trajnuar të gjithë anëtarët e komisioneve të zgjedhjeve (KZZ, KZQV, KQV), të ketë bërë testimin e tyre dhe në përfundim t'i ketë pajisur ata me certifikatën përkatëse që do të vërtetojë aftësinë e tyre për të kryer këtë detyrë.

Që të realizohet ky rekomandim, propozimet ose përzgjedhja e anëtarëve të komisioneve të mësipërme duhet të përfundojë brenda muajit Nëntor 2004.

Duke patur parasysh efikasitetin e Komisionit të veçantë dy-palësh parlamentar për reformën zgjedhore dhe faktin se mandati i këtij Komisioni përfundon në 5 Tetor 2004, vihet në pikëpyetje jo vetëm hartimi dhe miratimi në kohën e duhur i projekt-ndryshimeve të Kodit Zgjedhor, por edhe cilësia në aspektin profesional ligjor dhe kushtetues të tij.

Para se projekti i ndryshimeve të Kodit Zgjedhor të miratohet nga Kuvendi, **KSHH-ja sugjeron që projekti i ndryshimeve të publikohet duke lënë një afat qoftë edhe të shkurtër për vërejtje dhe sugjerime, për diskutimin e tij në rrethe të gjera të specialistëve, në median e shkruar dhe atë elektronike.** Në të kundërtën mund të përsëritej përvoja negative e procedurës që u ndoq në miratimin e Kodit Zgjedhor të vitit 2003 dhe që u lejuan defekte të rëndësishme, madje edhe dispozita antikushtetuese.

Komuniteti Ndërkombëtar është shprehur qartë e prerë që zgjedhjet e ardhshme parlamentare janë një test për integrimin e shqipërisë në strukturat euro-atlantike.

Me këtë rast, **Komiteti Shqiptar i Helsinkit e shikon të nevojshme t'u bëjë thirrje të gjitha forcave politike dhe Qeverisë që të vlerësojnë seriozisht situatën e krijuar.**

4. Njoftim për shtyp - ME TEPËR TOLERANCË NDAJ MEDIAS, MË TEPËR KUJDES PËR HEQJEN E IMUNITETIT

Tiranë, 25.09.2004

Para disa kohësh, bashkëshortja e Kryeministrit, zonja Xhoana Nano, i është drejtuar gjykatës me kërkesën kundër deputetit z. Nikollë Lesi për akuzën e fyerjes dhe shpifjes.

Dje në datën 24 shtator 2004, Gjykata e Lartë arriti në përfundimin se ekzistojnë kushtet ligjore për të kërkuar nga Kuvendi, heqjen e imunitetit të z. Lesi për të mundësuar shqyrtimin e plotë gjyqësor të pretendimeve të akuzueses.

Nuk është në kompetencën e Komitetit Shqiptar të Helsinkit të vlerësojë bazueshmërinë ligjore të vendimit të Gjykatës së Lartë. **Megjithatë lidhur me shqyrtimin e këtij vendimi nga Kuvendi, e shikojmë të nevojshme të shprehem si më poshtë:**

KSHH mendon se në këtë rast, trajtimi i këtij problemi nuk duhet shikuar vetëm nga ana formalo-ligjore.

KSHH ka bindjen se Kuvendi do ta vlerësojë atë duke iu referuar në radhë të parë parimit të tolerancës që duhet të shfaqet nga personalitetet e larta shtetërore dhe shoqërore në drejtim të medias edhe në ato raste kur ajo e kalon masën, madje edhe kur e tepron atë ose nuk tregon kujdesin e duhur për vërtetimin e fakteve dhe të burimit të informacionit. Ky është qëndrimi konsequent edhe i Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Në këtë drejtim KSHH është prononcuar publikisht edhe në raste të tjera të kësaj natyre.

KSHH është i ndërgjegjshëm se akuzat kundër z. Lesi është ngritur jo nga kryeministri, por nga bashkëshortja e tij që nuk hyn në radhën e personaliteteve. Megjithatë, KSHH ka mendimin se përderisa akuzuesja ka një pozitë të veçantë në shoqëri, çështja implikon indirekt edhe kryeministrin e Shqipërisë.

Duke marrë parasysh sa më sipër KSHH i bën thirrje Kuvendit që në dhënien ose jo të autorizimit për ndjekje penale të z. Nikollë Lesi, që njihet jo vetëm si botues por edhe si gazetar profesionist, të tregojë objektivitet.

KSHH mendon se mosdhënia e autorizimit nuk do ta dobësonte përgjegjësinë e medias së shkruar dhe asaj elektronike ndaj publikut të gjerë dhe as do të interpretohej si e drejtë për të cënuar dinjitetin e njeriut apo intimitetit e jetës private.

Veç sa më sipër, KSHH i propozon Kuvendit t'i përgjigjet një problemi të shtruar prej kohësh: atij të miratimit të ligjit për median jo për të penalizuar gazetarët por për një mbrojtje më efektive të lirisë së shtypit. KSHH mendon gjithashtu, se miratimi i këtij ligji do të ndërgjegjësojë në një shkallë më të lartë funksionin dhe kontributin e medias në një shoqëri demokratike, përgjegjësinë e saj morale, si dhe etikën gazetareske.

ANEKS NR. 2

Deklaratat e KSHH-së gjatë këtij muaji kanë gjetur një pasqyrim të gjërë në median e shkruar, ato janë publikuar rreth **18 herë**.⁶

Aktivitetet e KSHH-së, konferenca, tryeza sensibilizuese, vëzhgime, etj, janë pasqyruar rreth **14 herë** në median e shkruar dhe atë elektronike.

Gjithsej janë dhënë **5 intervista** gjatë këtij muaji dhe janë botuar shkrime në median e shkruar, të cilat janë botuar në gazetat si Koha jonë (5.09.04), Zëri i Popullit (21.09.04), Panorama (21.09.04), Korrieri (26.09.04) dhe në TV Klan (15.09.04).

Përgatiti për Internet: **Etilda SALIU**
Juriste/As.projektesh

Për më shumë informacion mund të na kontaktoni në adresën:

Komiteti Shqiptar i Helsinkit

Rr: Gjin Bue Shpata; Pall. 5/1, Ap.4, Tiranë, Kutia
postare Nr. 1752

Tel: 04 233671 & 04 229002

Fax: 04 233 671

E-mail: office@ahc.org.al; web site: www.ahc.org.al

⁶ KSHH ka monitoruar disa gazeta të përditshme